



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.6.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA
E FINANCAVE DHE EKONOMISË (HUAMARRËSI), OPERATORIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE), SH.A. (AGJENCIA
ZBATUESE E PROJEKTIT) DHE KFW, FRANKFURT AM MAIN (KFW), PËR
PROGRAMIN E INVESTIMEVE PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE I”**

• ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11 qershor 2019, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a. (agjencia zbatuese e projektit) dhe KFW, Frankfurt Am Main (KFW), për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj z. Ervin Bushati.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, **përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.**

• ***Baza kushtetuese e projektligjit.***

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin bazuar në nenet 81, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si

dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit.

- **Qëllimi, përmbajtja dhe rrishtë e projektligjit.**

Marrëveshja e huasë, që parashikohet të ratifikohet me këtë projektligj mbështetet në marrëveshjen kuadër midis qeverive të të dy vendeve, Shqipërisë dhe Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016, për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”, të ratifikuar këtë vit nga Kuvendi.

Marrëveshja e huasë parashikon që Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, nëpërmjet KFW-së, t’i akordojë vendit tonë një hua në vlerën 30 milionë euro. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësohet nga Ministria e Financave. Përfituesi i drejtpërdrejtë i huasë është Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, në rolin e agjencisë zbatuese të programit. Këshilli i Ministrave është në rolin e garantuesit të huasë.

Programi që do të financohet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të ndihmojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve në rrjet, si dhe rritjen e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për konsumatorët. Ky program synon mbështetjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit elektroenergjitik, si një ndër sektorët prioritarë për zhvillimin e ekonomisë.

Kostoja totale e programit është 32 milionë euro. Kjo kosto do të financohet nga huaja e parashikuar në këtë marrëveshje prej 30 milionë eurosh, si dhe nga një grant prej 2 milionë eurosh, që do të përfitohet nëpërmjet një marrëveshjeje tjetër me KFW-në. Granti do të përdoret për financimin e masave të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e programit. Vlera e TVSH-së dhe kostot lokale për këtë program do të mbulohen nga buxheti i OSHEE-së.

Termat e huasë janë:

- Norma e interesit është një normë fiske vjetore, e cila do të përcaktohet një ditë pas njoftimit ndaj KFW-së se marrëveshja është bërë efektive;
- Tarifa e angazhimit është 0.25 për qind mbi shumën e padisbursuar të kredisë;
- Tarifa e menaxhimit është 1 për qind mbi shumën e kredisë;
- Maturimi është 12 vjet, duke përfshirë periudhën prej 4 vjetësh pa pagesë principali.

Kjo hua do t’i nënhuazohet OSHEE-së me të njëjtat terma dhe kushte financiare sipas kësaj marrëveshjeje.

Përcaktimi i normës së interesit menjëherë pas bërjes efektive të huasë është kërkuar nga KFW, për të bërë të mundur krijimin e bazës së nevojshme ligjore në të cilën ajo do të bazohet. Besueshmëria

për përcaktimin e një norme të favorshme interesi nga KFW bazohet në këto argumente:

- KFW është një institucion i vlerësuar maksimalisht (AAA) nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit të riskut dhe mundëson refinancimin e kredive me kushte shumë të favorshme në tregun e kapitaleve;
- Marrëveshja qeveritare mbi të cilën bazohet kjo marrëveshje huaje parashikon që kredia e KFW-së prej 30 milionë eurosh të jetë kredi me terma të favorshme dhe qeveria gjermane do të subvencionojë diferencën midis normës nominale dhe normës reale të interesit;
- KFW raporton pranë OECD-së për kreditë për zhvillim (siç është kjo kredi) dhe plotësimin e kriterëve përkatëse;
- Kreditë e akorduara nga KFW në 10 vjetët e fundit kanë pasur norma interesi 1-2 për qind (tri herë më e ulët se norma e interesit të eurobondit, ndërkohë që afati i maturimit është më i gjatë se i eurobondit);
- Në ditën e negociimit të marrëveshjes norma e interesit ishte 1.3 për qind. KFW parashikon që norma e interesit për këtë hua të jetë më e vogël se 2 për qind.

• ***Diskutimi në Komision.***

Relatori paraqiti projektligjin, duke u ndalur në rolin që ai do të luajë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Propozuesit e projektligjit paraqitën një informacion të zgjeruar për marrëveshjen, si dhe impaktin pozitiv që ajo pritet të sjellë në përmirësimin e sektorit të energjisë elektrike. Pas pyetjeve dhe përgjigjeve, mbledhja vijoi me diskutimet e anëtarëve të Komisionit. Ata theksuan se marrëveshja e huasë do të sigurojë financimin e nevojshëm për reduktimin e nivelit të humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes; përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes; si dhe rritjen e cilësisë, efikasitetit dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për konsumatorin shqiptar. Kjo marrëveshje krijon kushtet për të çuar më përpara reformën në sektorin energjitik, si një ndër sektorët prioritarë të ekonomisë.

Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi **me shumicë votash.**

RELATORI

Ervin BUSHATI

KRYETARI

Arben AHMETAJ